# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-454759**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Jo në emrin tim!” 40 minuta në shesh, mbyllet protesta e tretë në Prishtinë, djemtë e çlirimtarëve mirënj ohës për përkrahjen: Nuk ndalemi (4 KËRKESAT) |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/rajon/jo-ne-emrin-tim-40-minuta-ne-shesh-mbyllet-protesta-e-trete-ne-prishtine-d-i401536` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 10:58:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 10:54:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `de7514bd5ade19e9c2cdf426d8771fabe61d20717ef755cb4d063addf08acab1` |
| TEKSTI | `4c4820fd8a0df97679490f5803645604d8412da5943b217b35f25cf473e826ec` |
| PAMJA | `f1933872faf6a079d2888666bdcd323c726c721a541a6f15498f27aa537aae86` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5f250852fa54c1e1d00e7d6da5877a03e7969b43ea08591b6e543eccc59c28eb` |
| E MËPARSHMJA | `0eb54e8ca3135121ab3c3612851d0895cc201f6b4389a23c10365bf578510c4e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5f250852fa54c1e1d00e7d6da5877a03e7969b43ea08591b6e543eccc59c28eb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Rajoni

18 Shtator 2026, 12:54

# “Jo në emrin tim!” 40 minuta në shesh, mbyllet protesta e tretë në Prishtinë, djemtë e çlirimtarëve mirënjohës për përkrahjen: Nuk ndalemi (4 KËRKESAT)

Shkruar nga Newsbomb




Altin Krasniqi, Endrit Thaçi dhe Klestor Veseli

Është mbyllur pas afro 40 minutash protesta qytetare e mbajtur në zemër të Prishtinës në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, ndërsa është paralajmëruar se tubimet do të vijojnë.

***“Shihemi në protestën e radhës!”*** u tha në mbyllje të protestës së sotme, ku të pranishëm ishin dhe djemtë e çlirimtarëve Endrit Thaçi, Klestor Veseli dhe Altin Krasniqi.

Pasi falenderuan për mbështetje e qytetarëve, djemtë e katërshes së UÇK-së u takuan me qytetarët e pranishëm duke shprehur mirënjohjen e tyre për ta. Ndërsa djali i Jakup Krasniqit, deputeti Altin Krasniqi mbajti dhe një fjalim, ku bëri me dije se asgjë nuk do t’i ndalë ata që të vijojnë betejën me drejtësinë, derisa për çlirimtarët të vuloset një vendim i duhur, siç është liria.



Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit


Aktualitet
Nga konfiskimi në streha për kafshët e braktisura, 7 mijë metra katrorë tokë në rrethinat e Tiranës vihen në dispozicion nga AAPSK


Aktualitet
U kap nga droni teksa kujdesej për bimët narkotike që kishte kultivuar, arrestohet 37-vjeçari në Mirditë

Zbulo më shumë artikuj




Altin Krasniqi duke mbajtur fjalim

Këshilluar për ty



**VIDEO/ Të veshur me logot e UÇK-së, djemtë e çlirimtarëve, Endrit Thaçi dhe Klestor Veseli rreshtohen në mesin e qindra protestuesve**

*"Ju falënderoj nga zemra për mbështetjen e vazhdueshme për luftën e UÇK-së. Lufta jonë ka qenë për liri për dinjitet. Për në aktgjykimi prek sakrificën e çdo dëshmori. Sot nuk do të dorëzohemi. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi. Askush nuk duhet të dënohet mbi bazën e provave të pa vërtetuara. Le t'i lëmë anash dallimet politike duhet të bashkohemi dhe të kërkojmë rrugët ligjore për të kërkuar një proces të drejt"* tha gjatë fjalës së tij Altin Krasniqi.

***"Jo në emrin tim!", "UÇK" dhe "Liria ka emër!",*** ishin thirrjet që mbizotëruan protestën e sotme.

Sakaq mësohet se në protestën e sotme të OVL dhe UÇK, kanë paraqitur katër kërkesa të cilat lidhen me vendimin e marrë në Hagë ndaj katërshes.

Konkretisht mësohet se në protestën e sotme u kërkua: ***shfuqizimi ose ndryshimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara***; ***shkarkimi i ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla***; m***bështetje e pakufizuar dhe fonde për mbrojtjen e katër ish-krerëve të UÇK-së të dënuar në shkallën e parë;*** dhe ***angazhim i ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë për mbrojtjen e tyre.***

Deri më tani akoma nuk ka detaje se kur do të mbahet protesta e radhës. Megjithatë një gjë është e sigurt, shqiptarët nuk do i ndalen tubimet e tyre derisa të merret vendimi i duhur për çlirimtarët e Kosovës.

Këshilluar për ty



**Mbushet sheshi "Skënderbeu", me imazhin e Hashim Thaçit të stampuar në bluzë, Endriti i bashkohet protestës së tretë, të pranishëm dhe politikanë (DETAJE-FOTO)**

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu





E Premte 12:45

## E rëndë në një shkollë të mesme në Romë, 13-vjeçari sulmon me sprej piper dhe thikë mësuesen



Rajoni

VIDEO/ Të veshur me logot e UÇK-së, djemtë e çlirimtarëve, Endrit Thaçi dhe Klestor Veseli rreshtohen në mesin e qindra protestuesve

E Premte 12:36 Newsbomb



Rajoni

Mbushet sheshi "Skënderbeu", me imazhin e Hashim Thaçit të stampuar në bluzë, Endriti i bashkohet protestës së tretë, të pranishëm dhe politikanë (DETAJE-FOTO)

E Premte 11:55 Newsbomb




E Premte 11:47

## Paga më të larta në Malin e Zi, qeveria prezanton "Euro Model": Nga janari rroga minimale deri në 1400 euro



Rajoni

"Një dimër i vështirë na pret", thotë



Rajoni

"Pa maska, me fytyrat tona"

"Një dimër i vështirë na pret", bota drejt krizës, Mitsotakis kërkon ndërhyrje evropiane për çmimet e karburanteve

E Premte 11:23

"Pa maska, me fytyrat tona", veteranët e UÇK-së protestojnë në Prishtinë pas vendimit të Hagës

E Premte 10:26




E Premte 09:51

## Ç'mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?



Rajoni

"Është krenar që ka luftuar për Kosovën e re", avokatja e Jakup Krasniqit: Asnjë dëshmitar nuk tha se ishte keqtrajtuar nga ai, përkundrazi, folën me shumë vlerësim (E PLOTË)

E Enjte 23:27



Rajoni

81 vite për Çlirimtarët, ish-emisari amerikan: Kosova nuk ka nevojë për një gjykatë në Holandë që të marrë vendime, sepse dënimi ishte i ndikuar politikisht

E Enjte 22:13




E Enjte 21:39

## Haga e bëri fajtor, Hashim Thaçi i drejtohet popullit dhe sfidon Gjykatën: Të bëhen publike provat për vrasjen e Heroit të Kosovës, Behajdin Allaqi




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.